

KARTELË INFORMATIVE

AL024004

1. Emri i shërbimit	Regjistrimi i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Përcaktimi i rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), që do të importohen, vendosen në treg dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	PMB-të tregtohen dhe përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm nëse janë të regjistruara, në përputhje me këtë vendim. Objektivi: Sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit nga përdorimi i PMB-ve. Forcimi i sigurisë ushqimore në çdo hallkë të zinxhirit ushqimor sipas parimit "nga ferma në tavolinë", ku përdorimi korrekt i produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe sipas etiketës zyrtare të miratuar për çdo PMB të regjistruar, është thelbësore në këtë hallkë të zinxhirit ushqimor.			
4. A jam përfitues?	Apikantët, që janë prodhues të PMB-ve ose persona apo subjekte të autorizuar prej tyre për regjistrimin e një PMB-je në Republikën e Shqipërisë			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Kërkesa për regjistrim në shqip	Aplikanti	Po
	2	Të dhënat teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-së, në gjuhën shqipe ose angleze, në dosje dhe në formë elektronike (CD)	Aplikanti	Po
	3	Të dhënat që provojnë se PMB-ja është e regjistruar nga aplikanti në një nga vendet e Bashkimit Evropian	Aplikanti	Po
	4	Dokumentacioni për të dhënat e sigurisë (MSDS)	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Tiranë	Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2	E Hënë - E Enjte, ora 08:00-16:30; E Premte, ora 08:00- 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	1. Për PMB- të, tërësia vepruese të cilave eshte e përfshirë në Aneksin 1 të Direktivës 91/414/EEC (me afat regjistrimi deri 10 vjet), me përjashtim të atyre të përfshira në pikat 2, 5, 6, 7 dhe 8- 300 000 lekë; 2. Për PMB- të, me natyrë inorganike- 150 000 lekë; 3. Për PMB- të me lëndë vepruese, që lejohet të përdoren por që akoma nuk janë përfshirë në Aneksin 1 të Direktivës 91/414/EEC (pa status të përcaktuar)-150 000 lekë; 4. Për PMB- të, identike me ato të regjistruarat-100 000 lekë; 5. Për rodenticidet, moluskicidet dhe vajrat mineralë- 100 000 lekë; 6. Për PMB-të, me lëndë vepruese me natyrë biologjike (bakterie, viruse, etj.)- 100 000 lekë; 7. Për rregullatorët e rritjes- 50 000 lekë; 8. Për feromonet, repelentët, ekstraktet dhe vajrat bimore, acidet yndyrore, etj- 10 000 lekë; 9. Për rinovimin e regjistrimit të PMB-ve, të përcaktuara në piken 1- 200 000 lekë; 10. Për rinovimin e regjistrimit të PMB-ve, të përcaktuara në piken 2 dhe 4- 100 000 lekë; 11. Për rinovimin e regjistrimit të PMB-ve, të përcaktuara në pikën 5 dhe 6- 50 000 lekë; 12. Për rinovimin e regjistrimit të PMB-ve, të përcaktuara në pikat 7 dhe 8- 10 000 lekë; 13. Për rinovimin e regjistrimit të PMB-ve, të përcaktuara në piken 3- 30 000 lekë;	Nuk ka		Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	65 ditë			
10. Çfarë përfitoj?	Certifikatë			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Deri 10 vjet (sipas vlefshmërisë së lëndëve vepruese, në përmbajtje të PMB-së)			
12. Ku e marr?	Në sportele	Me postë	E-albania	Me e-mail
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)			Orari
	Kontakto në:			

14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	E- albania:e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al MBZHR web: www.bujqesia.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118	Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00- 19:00
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/> Me postë <input checked="" type="checkbox"/> Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/> Me e-mail <input type="checkbox"/> Në platformën "Shqipëria që duam" <input checked="" type="checkbox"/> Link: www.shqiperiaqeduam.al	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve"; Vendimi nr 335, datë 6.6.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve".	